



REPUBLIKA E KOSOVËS  
REPUBLIKA KOSOVA – REPUBLIC OF KOSOVO  
**GJYKATA THEMELORE NË PRIZREN**  
OSNOVNI SUD U PRIZRENU – BASIC COURT OF PRIZREN

---

**AD-GJTHPZ.nr.13/23**

GJYKATA THEMELORE NË PRIZREN, Kryetarja e Gjykatës Shpresa Emra, duke vepruar sipas kërkesës për inicim të procedurës disiplinore të parashtruar nga ana e ankuesit KEL Energy SHA Ferizaj të cilin me autorizim e përfaqëson J.U., nga Ferizaji, ndaj gjyqtarit R.T., gjyqtar në Gjykatën Themelore në Prizren, Dega në Suharekë, Departamentin e Përgjithshëm-Divizioni Civil, lidhur me veprimet dhe sjelljen e gjyqtarit të lartcekur sipas lëndës C.nr. 110/19, në bazë të së cilës është bërë inicimi i procedurës disiplinore, me dt.07.07.2023 mori këtë:

## **A K T V E N D I M**

**REFUZOHET si e pabazuar** ankesa e ankuesit K...Energy SHA Ferizaj të cilin me autorizim e përfaqëson J.U., nga Ferizaji, e paraqitur ndaj gjyqtarit R.T., gjyqtar në Gjykatën Themelore në Prizren, Dega në Suharekë, Departamentin e Përgjithshëm Divizioni Civil.

### **A r s y e t i m**

Parashtruesi i ankesës K...Energy SHA Ferizaj të cilin me autorizim e përfaqëson J.U., nga Ferizaji ka parashtruar Kërkesë për inicim të procedurës disiplinore në Këshillin Gjyqësor të Kosovës ndaj Gjyqtarit R.T., gjyqtar në Gjykatën Themelore në Prizren, Dega në Suharekë, Departamentin e Përgjithshëm-Divizioni Civil, lidhur me lëndën civile C.nr.110/19.

Ankuesi në ankesën e parashtruar në Këshillin Gjyqësor të Kosovës e cila është përcjellë tek Autoriteti Kompetent të Gjykatës Themelore në Prizren ka cekur se gjyqtari R.T., ka shkelur dispozitat e procedurës civile, ka shkelur Rregulloren Nr.02/2023 në çasje në dokumentet publike dhe të nenit 41 të Kushtetutës së Kosovës pasi që nuk ka dërguar aktvendimin për hedhje të padisë në lëndën C.nr. 1 10/19 dhe ka refuzuar kërkesën për kthim në gjendje të mëparshme në lëndën e lartcekur. Respektivisht ankuesi, në rastin konkret përfaqësuesi i autorizuari paditësit K...Energy SHA Ferizaj, J.U., nga Ferizaji ka parashtruar padi për mos pagesën e shërbimeve dhe furnizimit ndaj të paditurës NNP"....." nga fshati Dubravë. Gjyqtari i çështjes R.T., ka caktuar seancën përgatitore me cit. 07.02.2022 ku i autorizuari i paditësit (ankuesi) është vonuar në këtë seancë 17 minuta dhe gjyqtari ka konsideruar këtë padi si të tërhequr dhe ka nxjerr Aktvendim C.nr. 1 10/19 të dt. 07.02.2022. Ankuesi ka kërkuar nga gjyqtari të caktojë seancën dhe të rikthen në gjendjen e mëparshme dhe ti dorëzohet aktvendimi i lartcekur pasi të njëjtin nuk e kanë pranuar, por gjykata ka refuzuar këtë kërkesë me cit. 02.09.2022 për arsye se ka kaluar afati ligjor për parashtrim të ankesës . Kundër këtij vendimi ankuesi ka parashtruar ankesë në Gjykatën e Apelit në Prishtinë me dt. 15.09.2022 dhe ende nuk kanë marrë përgjigje nga kjo gjykate. Gjyqtari i çështjes në vend se të dërgojë Aktvendimin ka konstatuar se pala është e panjohur pasi që ka ndryshuar ankesën dhe pas dy tentimeve Aktvendimin e ka shpallur në tabelë të shpalljeve. Ankuesi ka dyshime në sjellje të gjyqtarit se i njëjti e njej të paditurin,

ka miqësi me te ose edhe ka marr ryshfet që të përfundojë këtë lëndë në këtë mënyrë. Të gjitha të lartcekurat sipas ankuesit janë veprime të padrejta dhe me këto veprime ka Shkelje si ka cekur më lartë andaj ka parashtruar ankesë dhe ka kërkuar që të aprovet ankesa e tij dhe që ndaj personit të lartcekur të mirën masa disiplinore.

Gjyqtari R.T., ka dhënë deklaratë në lidhje me lëndën civile C.nr.1 10/19 ku ka cekur se në këtë çështje ka vendosur si gjyqtar i çështjes ku si palë paditëse ka qenë K....Energy SHA Ferizaj të cilin me autorizim e përfaqëson J.U., nga Ferizaji dhe lënda e kontestit ka qenë për borxh. Me dt. 07.02.2022 ka nxjerr Aktvendim C.nr.110/19 me të cilin padia është konsideruar e tërhequr pasi që paditësi i ftuar në mënyrë të rregullt nuk është paraqitur në shqyrtim dhe mungesën nuk e ka arsyetuar. Përfaqësuesi i autorizuar i paditësit ka parashtruar kërkesë për kthim në gjendje të mëparshme duke u arsyetuar se ka ardhur me vonesë në shqyrtim. Këtë kërkesë gjyqtari e ka refuzuar dhe kundër këtij aktvendimi paditësi ka parashtruar Ankesë në Gjykatën e Apelit ku ende nuk është vendosur për këtë ankesë. Gjyqtari ka deklaruar se në asnjë rast nuk e ka trajtuar në mënyrë të pabarabartë paditësin, nuk ka pas vonesë në trajtim dhe se në vendimmarrje ka qenë i paanshëm dhe i pandikuar, ka vendosur në bazë të provave dhe se shkresat janë komunikuar dhe dërguar në përputhje me Ligjin për Procedurën Kontestimore.

Autoriteti kompetent - Kryetarja e gjykatës pasi që ka pranuar ankesën drejtuar Këshillit Gjyqësor të Kosovës, ka iniciuar hetimet preliminare për procedurë disiplinore dhe ka ndërmarrë disa veprime në këtë drejtim. Fillimisht ka bërë shikimin në ankesën e parashtruar, ka kërkuar deklaratë nga gjyqtari i çështjes R.T., ka bërë verifikimin e shkresave të lëndës C.nr.110/19. Pas vlerësimit dhe analizës së tërësishme të provave të mbledhura Autoriteti Kompetent konsideron se:

Ankesa është e pabazuar.

Autoriteti kompetent - Kryetarja pas verifikimit të gjithë dokumentacionit ka vërtetuar gjendjen faktike si vijon:

Ankuesi ka vërejtje në punën e gjyqtarit R.T., lidhur me lëndën civile C.nr. 1 10/19 ku pretendon se gjyqtari ka bërë Shkelje të dispozitave të procedurës civile dhe shkeljes së rregullores për çasje në dokumente publike pasi që, nuk i ka dërguar aktvendimin për hedhje si dhe ka refuzuar kërkesën për kthim në gjendjen e mëparshme. Autoriteti kompetent sa konstatuar se, gjyqtari R.T., ka qenë i ngarkuar me lëndën civile C.nr.1 10/19, ku si paditës ka qenë KEL — Energy Sh.A Distrikti në Ferizaj me përfaqësues të autorizuar J.U., si i paditur ka qenë NNP ' .....' nga fshati Dubravë, kurse lënda e kontestit mos pagesë për shërbime dhe furnizim. Gjyqtari shqyrtimin përgatitor ka caktuar me datë 07.02.2022 ku sipas procesverbalit të kësaj date i autorizuari i paditësit nuk është paraqitur në seancë, ka qenë i ftuar në mënyrë të rregullt dhe mungesën nuk e ka arsyetuar, në seancë ka qenë prezent i autorizuari i palës së paditur. Bazuar në konstatimin për mos prezencë të paditësit gjyqtari ka konsideruar se padia është tërhequr. Me shikimin në fletëkthesën e Gjykatës Themelore Prizren —Dega në Suharekë, është vërtetuar se pala paditëse K..... — Energy Sh.A Distrikti në Ferizaj ka pranuar ftesën me datë 20.01.2022 dhe e njëjta është nënshkruar në mënyrë të rregullt. Këtë fakt ka vërtetuar edhe vetë paditëse por ka cekur se është vonuar në seancë dhe gjyqtari nuk e ka marrë për bazë këtë vonesë. Më tutje aktvendimi C.nr. 1 10/19 me të cilin është vendosur se padia është e tërhequr është tentuar dorëzimi paditësit K..... — Energy Sh.A Distrikti në Ferizaj, me datë 10.02.2022 dhe 24.02.2022 ku në konstatim të dorëzuesit (postës) qëndron se pala është shpërngulur dhe se lokali është mbyllur. parasheh ligji, pasi që paditësi gjykatën nuk e njoftuar për adresën e re dhe gjykata nuk ka pasur informatë se ku ta dërgoj aktvendimin. Pas kësaj, paditësi me datë 01.09.2022 ka parashtruar kërkesë për kthim në gjendjen e mëparshme për arsye se nuk e ka pranuar vendimin për tërheqje të padisë. Ka kërkuar që të rikthehet afati për ankim nga dita e

pranimi të aktvendimit dhe nga kjo të datë të shqyrtohet kërkesa për kthim në gjendje të mëparshme dhe kjo lëndë të trajtohet me prioritet. Gjyqtari në lidhje me kërkesën për kthim në gjendjen e mëparshme të lartcekur me aktvendim C.nr. 1 10/19 të datës 02.09.2022 e ka hedhur poshtë si të palejuar pasi që është paraqitur jashtë afatit ligjor, bazuar në nenin 130 par.2 të LPK-së. Ankuesi ndaj këtij aktvendimi me datë 15.09.2022 ka parashtruar ankesë në Gjykatën e Apelit. Tani kjo lëndë është bartur nga Gjykata e Apelit në Gjykatën Komerciale pasi sipas kompetencës i takon kësaj gjykate dhe ende nuk është vendosur për këtë çështje.

Autoriteti Kompetent konsideron se gjyqtari ka vepruar në mënyrë të drejtë me rastin e mbajtjes së seancës përgatitore pasi që ankuesi i ftuar në rregullt nuk është paraqitur në seancë, mungesën nuk e ka arsyetuar dhe për këtë arsye gjyqtari ka konsideruar se padia është tërhequr e Cila është paraparë edhe me LPK, gjithashtu edhe dorëzimi i aktvendimit është zbatuar në mënyrë të rregullt bazuar në dispozitat e LPK-së, pasi që dy herë është tentuar dorëzimi i rregullt dhe herën e tretë është bërë shpallja në tabelën e gjykatës. Sa i përket, vendimit me të cilën është hedhur poshtë kërkesa për kthim në gjendjen e mëparshme, për të njëjtën është paraqitur ankesë në Gjykatën Komerciale — Gjykatën e Apelit, gjykata e shkallës së dytë do të vendos në lidhje me këtë vendim. Gjithsesi në ankesë janë cekur shumë çështje për të cilët paditësi K..... - Energy Sh.A me përfaqësues J.U., kanë vërejtje dhe se duke pasur parasysh se lënda gjendet në Gjykatën Komerciale, konsiderojmë se kemi të bëjmë me ankesë për Shkelje të dispozitave të procedurës dhe nuk kemi prova të cilët na tregojnë se kemi të bëjmë me Shkelje disiplinore të cilat i ka kryer gjyqtari i çështjes.

Për arsyet që u cekura më lartë, Autoriteti Kompetent — Kryetarja e Gjykatës ka vendosur si në dispozitiv të aktvendimit në kuptim të nenit 9 paragrafi 6 lidhur me nenin 17 paragrafi 5 të Ligjit nr.06/L-057 për përgjegjësinë disiplinore të Gjyqtarëve dhe Prokurorëve.

## **GJYKATA THEMELORE NË PRIZREN**

**AD-GJTHPZ.nr.13/23, me dt. 07.07.2023**



**KËSHILLË JURIDIKE: Kundër këtij aktvendimi, nuk e lejuar e drejta e ankesës.**